



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401076/4

Tirane ___/___/2013

Lënda : *Rekomandojmë që të shikohet mundësia e shpejtimit të gjyimit të çështjes civile me Nr.1030/13 Akti, datë 02.10.2013 nga Gjykata e Apelit Tiranë.*

Drejtuar : **Z. Alaudin MALAJ**
Kryetar i Gjykatës së Apelit

Për dijëni : **Zj.Marsita XHA FERLLARI**
K/Inspektore e KLD-së

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e saj datë 02.04.2014 dejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, Shoqata në dobi të gruas shqiptare, përfaqësuar nga Zj. S. A. ankohet për zvarritje gjykimi dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me gjykimin e një çështje civile me Nr.1030 akti, datë 02.10.2013 me kërkuese F. L. (E.).

Në ankesën e saj, përfaqësuesja ka pretenduar se ky gjykim i zhvilluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë 26.06.2013 është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj pasi gjyqtari i kësaj çështje Z. Ridvan Hado është treguar i njëanshëm në gjykim duke mospranuar si palë e interesuar përfaqësuesen e kësaj shoqate, sipas disponimeve të dispozitave ligjore të neneve 189, 191, 192 të Kodit Procedurës Civile. Për çudi thuhet në ankesë se pas përfundimit të gjyimit të kësaj kërkesë, gjyqtari çështjes Ridvan Hado transferohet menjëherë si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku vazhdon të ndikojë me influencën e tij për mbrojtjen e saj që ky gjykim të mos cënohet por të mbetet në fuqi siç e ka gjykuar ai.

Rezultoi se përfaqësuesja e kësaj shoqate është ankuar me shkrim edhe tek Ministri i Drejtësisë, Z. Nasip NAÇO, dhe tek Presidenti i Republikës, Z. Bujar Nishani i cili është edhe Kryetar i KLD-së për këto probleme ndaj gjyqtarit Ridvan Hado se ky gjyqtar është treguar i njëanshëm në gjykim dhe se gjatë këtij gjyimit ky gjyqtar ka kryer shkelje të rënda procedurale për të cilat ai duhet analizuar dhe të vihet para përgjegjësisë disiplinore, pasi ai ka

favorizuar padrejtësisht kërkuessen F. L.(E.), duke dëmtuar hapur rëndë të drejtat dhe interesat e kësaj shoqate.

Nga studimi me kujdes i kësaj ankese dhe i dokumentacionit të paraqitur tek ne, me anën e së cilës kërkohet ndihmë dhe mbështetje nga institucioni i Avokatit të Popullit për të parë mundësitë ligjore dhe procedurale të shpejtimit të këtij gjykimi në të ardhmen nga Gjykata e Apelit Tiranë, u vlerësua që duke u bazuar në të drejtat kushtetuese dhe ligjore nga ana jonë të dërgohet ky rekomandim.

Nga vendimi gjyqësor Nr.7315 datë 26.06.2013 i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultoi se mbi kërkesën e kërkuess F. L. (E.), Gjykata ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë duke vendosur prishjen me nënvizim për depozitimin e proces - verbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqatës në dobi të gruas shqiptare, datë 19.01.2013 si regjistrim i pavlefshëm. Nga vendimi gjyqësor rezulton se përfaqësuesja e kësaj shoqate jo vetëm që nuk është pranuar si palë e interesuar në këtë gjykim, por ajo nuk pranohet as të jap shpjegime në gjykim apo të paraqes prova e dokumenta që do të zbardhinin të vërtetën për zgjidhjen sa më drejtë të kërkesës së kërkuesses.

Janë këto arsyt kryesore për të cilat ankuesja pretendon se në rastin konkret gjykata nuk ka zhvilluar një proces të rregullt, dhe se këto veprime të parregullta vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se:”Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejt dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj.

Po kështu ankuesja pretendon se Gjykata në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 4 të Kodit Procedurës Civile, ku thuhet se:”Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor”, dhe kërkesat e nenit 14 të këtij Kodi, ku thuhet se:”Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimit të plotë e të gjithanshëm në përputhje me ligjin”.

Nga ankesa rezultoi se vendimi gjyqësor është dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me datën 26.06.2013 dhe deri më sot ka kaluar rreth 1 vit pa u gjykuar akoma dhe se këto vonesa apo zvarritje të padrejta të gjykimeve janë shprehur qartë edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe Gjykata Kushtetuese duke përcaktuar se:”**Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar**”. “E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paanëshme të caktuar me ligj **kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por ajo edhe duhet të shihet se po bëhet**”.

Prandaj duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”, dhe bazuar në kërkesat e nenit 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se:”Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të

njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Për sa më sipër, Ju

R E K O M A N D O J M Ë :

1.Të shikohet mundësia procedurale e shpejtimit të gjykimit të çështjes civile Nr.1030 akti, datë 02.10.2013 nga Gjykata e Apelit Tiranë.

2.Mbi qëndrim dhe masat e marra në lidhje me rekomandimin në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, lutemi na njoftoni me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI